



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

Data: 9.4.2024

Nr: 36

Ora: 12:00

**VENDIM**  
**PËR**

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË FIER, ME KANDIDATIN**  
**NGA LISTA SHUMEMËRORE E “PARTISË DREJTËSI, INTEGRIM DHE UNITET”.**  
**ZJ. BRUNILDA ABAS ÇAMI**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreut V, të Vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

**VËREJ:**

Me shkresën nr. 1404/4 prot., datë 7.3.2024, Këshilli i Bashkisë Fier, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga Këshilltari, z. Ylvi Sulejman Sulejmani, propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet”.

Referuar nenit 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e “Partisë Drejtësi, Integrim dhe Unitet”, për Këshillin e Bashkisë Fier, të cilit, i kalon mandati i Këshilltarit, është kandidati me numër rendor 2, zj. Brunilda Abas Çami.

Me shkresën nr. 708, prot., datë 11.3.2024, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Fier, zj. Brunilda Abas Çami, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Këshillin Bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e Këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për Këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumemërore, të subjektit “Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet”, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër FR\_PDIU-1117\_1 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i Këshilltarit të Bashkisë.

Data: 9.4.2024 Nr: 36  
Ora: 12:00



“Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Fier me kandidatin nga lista shumemërore e “Partisë Drejtësi, Integrim dhe Unitet”, zj. Brunilda Abas Çami”.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të zj. Brunilda Abas Çami, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të Vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016, me shkresën nr. 774 prot., datë 20.3.2024, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe me shkresën nr. 773 prot., datë 20.3.2024, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore për zj. Brunilda Abas Çami.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 3313/1 prot., datë 29.3.2024 ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar zj. Brunilda Abas Çami, ku konstatohet se kandidati nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 4189/1 prot., datë 28.3.2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për zj. Brunilda Abas Çami, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të Vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016, konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar zj. Brunilda Abas Çami, në Këshillin e Bashkisë Fier, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e Këshilltarit.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreun V, të Vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

### **V E N D O S:**

1. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Fier, me kandidatin nga lista shumemërore e “Partisë Drejtësi, Integrim dhe Unitet”, zj. Brunilda Abas Çami.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**